



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

Nr. 233 prot.

Tiranë, më 13.06.2025

URDHËR

Nr. 186 Datë 13.08.2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 183, DATË 01.11.2022 "PËR PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË TESTIMIT TË INFORMATIZUAR PËR MATURANTËT NË KUADËR TË PRANIMIT NË PROGRAMIN "MJEKËSI E PËRGJITHSHME", NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 5047/5 prot., datë 24.10.2022 "Për testimin e informatizuar për maturantët në kuadër të pranimit në programin "Mjekësi e Përgjithshme", në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Universitetit të Mjekësisë Tiranë, si dhe të Urdhrit nr. 183, datë 01.11.2022 "Për miratimin e rregullores për procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të testimit të informatizuar për maturantët në kuadër të pranimit në programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme", në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë",

URDHËROJ:

Në Urdhrin nr. 183, datë 01.11.2022 "Për miratimin e rregullores për procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të testimit të informatizuar për maturantët në kuadër të pranimit në programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme", në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pikat 1 dhe 2 të nenit 13, ndryshojnë si më poshtë:

"1. Aplikimi për pjesëmarrje në testimin e informatizuar në kuadër të pranimit në programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme" në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kryhet online në portalin qeveritar e-Albania, nëpërmjet shërbimit "Aplikim për provimin e pranimit në programin "Mjekësi e Përgjithshme".

2. Qendra e Shërbimeve Arsimore bazuar në aplikimet e pranuara publikon në faqen e saj zyrtare kalendarin e organizimit të testimit të informatizuar, si dhe orarin e pjesëmarrjes në testim për çdo kandidat”.

2. Pika 1/k e nenit 16, ndryshon si më poshtë:

“Përcjell rezultatet e testimit të informatizuar të dërguara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin”.

3. Pika 2, e nenit 21, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

ME URDHËR DHE POROSI

ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Anis Theodorjani

